



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Pradato Received/Delivery	07-04-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	1646/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.156/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.156/2021 të datës 19.03.2021, të parashtruar nga me adresë rruga "Bedri Gjini", Nr. 43 në Prishtinë, kundër Njoftimit të datës 17.03.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.156/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Njoftimi i datës 17.03.2021 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për ankuesin
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Administrator i TI-së për baza të të dhënave", më datë 15.03.2021 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së njerësit. Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës përmes njoftimit të

datës 17.03.2021 ka njoftuar ankuesin që bazuar në dispozitat ligjore në fuqi njerka nuk është anëtare e ngushtë e familjes dhe nuk mund të lejohet pagesa e pagës mesatare.

Ankuesi, i pa kënaqur me njoftimin e datës 17.03.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, më datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:1270/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 23.03.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Prishtinës. Këshilli me datë 31.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.156/2021 të datës 19.03.2021 me Nr. Prot:1270/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesën e datës 15.03.2021 e parashtruar nga ankuesi; Njoftimin e datës 17.03.2021; Certifikatë e vdekjes e datës 15.03.2021; Certifikatë e Martesës e datës 15.03.2021; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendje Civile i datës 15.03.2021; Letërnjoftim i Sala Marolli; Letërnjoftim i ankuesit; Certifikatë për Bashkësinë Familjare Nr. F 11046120; dhe Përgjigjen në ankesë e datës 31.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeie ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së njerkes, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Ligji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht neni 1 dhe 2 të këtij Ligji, që jep përkufizimin e familjes, si dhe neni 271 ku përcaktohet se: *“Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”*. Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil, me rastin e vdekjes se anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatën e Martesës M 11133219 të datës 15.03.2021, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se znj. (në këtë rast njerka e ankuesit) ka lidhur martesë me babain e ankuesit, po ashtu në bazë të Certifikatës për Bashkësinë Familjare F 11046120, si bashkësi familjare përveç ankuesit, bashkëshortes, djalit dhe vajzave të tij, bënë pjesë edhe babai i tij, ndërsa para vdekjes edhe njerka e ankuesit ka qenë pjesë e bashkësisë familjare mirëpo e njëjta pas vdekjes më nuk është pjesë e bashkësisë familjare, e cila në bazë të Certifikatës së vdekjes V 10388315 të datës 15.03.2021 ka vdekur më datë 02.03.2021, Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se edhe njerka e ankuesit është në bashkësi familjare me ankuesin sepse kanë jetuar në shtëpi të përbashkët.

Duke iu referuar nenit 22 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, si dhe nenit 1, 2 dhe 271 të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen në Kosovës, Kolegji për shqyrtimin



e ankesave, vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së njerëzës, është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 22 paragrafi 2.4 përcakton se: "2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil" si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 22, ku përcaktohet se: "2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil", dhe si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, në këtë rast Kryetari i Komunës së Prishtinës, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për ankuesin Faton Marolli.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.156/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

